

SHKOLLA 9 VJEÇARE “SAMI ZGJANI” GURAS, NJESIA ADMINISTRATIVE BUÇIMAS

RELACION ARGUMENTIMI

Shkolla 9 vjeçare” Sami Zgjani” ndodhet ne rrugen kryesore te fshatit Guras, ne pjesen perendimore te fshatit.

Karakateristika te gjendjes egzistuese

Shkolla

- numri i pergjithshem i nxenesve 169
- numri I klasave 9
- numri I personelit 19
- numri I banjave WC per nxenesit 4
- numri I banjave WC per personelin (_s'ka) dhe banjo ne katin perdhe
- nuk ka laboratore
- nuk ka ambiente per programe sportive – palesterjashte funksionit.
- sistemi i ngrohjes qendror (nuk ekziston). Ngrohja realizohet me soba te vjetra me dru zjarri.

Te dhena teknike

Kjo shkolle eshte ndertuar ne vitet 1973-1974.

Gjate kesaj kohe jane realizuar meremetime mirembajtjeje te pjeseshme te godines

-Shkolla perbehet nga nje godine 2 kat

Nga ana konstruktive godina eshte realizuar me mur tulle 38 cm dhe

konstrukcioni -me trare b/a dhe ndershtrese me binare dhe dysHEME me derrasa.

Gjate ecjes se nxenesve ne korridore dhe klasa ka tronditje ne objekt duke ndikuar ne qetesine dhe procesin e mesimdhenies

Te dhenat e vleresimeve “Vleresimi fizik i objektit”dhe “Vleresimi sipas standarteve”,japin listimin e meposhtem ,sipas renditjes,te nevojës per investim ne rast se merret opsioni i rikonstruksionit jane:

1. Ndertim çati e re
2. Zevendesim dyer e dritare te reja
3. Rikonstruksion i plote i palestres
4. Rikonstruksion i banjove dhe ndertimi i banjove te reja
5. Sistemimi i oborrit te jashtem
6. Ndertimi i terreneve sportive
7. Shtrim me pllaka ,suvatim e lyerje
8. Rikonstruksion i fasades
9. Te tjera sipas problematikave

Sugjerime:

- Rrethimi i plote i shkolles
- Ambjente per laboratore



-Sistemi i ngohjes

Sistemi ekzistues eshte I perbere nga soba me dru zjarri. Nuk ekziston ngrohje qendrore.

Struktura mbuluese

Mbulesa eshte e realizuar çati. Binaret jane mjaft te vjeter dhe kane krijuar kurbezime si rezultat i kohes.

Si rezultat i materialeve te perdorura ne çati dhe amortizimit te tyre kohor dhe atmosferik ka humbur funksioni per te cilen jane ndertuar dhe rezulton me pikime dhe rrjedhje uji ne tavanet e katit te dyte dhe te mureve perimetrale.Gjithashtu sistemi i grumbullimit dhe largimit te ujrave (ulluket) eshte jashte standartit .

-Shtresat

Shtresat ne pegjithesi shtresat e dysHEMEVE te koridoreve dhe disa ambienteve te tjera jane te realizuara me binare druri te konsumuara nga koha, ndoshta te thyera te plasaritura .

-Suvatimet e brendeshme dhe te jashtme

Per shkak te vjetersise se shkolles, problemeve të hidro dhe termohizolimit me pasoje krijimin e lagështisë dhe ftohtësisë te vazhdueshme në ambientet poshtë strukturës mbuluese jane shkaktuar dëmtime te suvatimeve në mure e tavane si dhe demtime ne fasada.Suvatimet ne korridore dhe banjo jane demtuar dhe nga faktori njeri.

Dyer dritare

Gjendja fizike e tyre rezulton:

Dritaret jane prej duralumini ,kurse dyert jane prej druri .Te gjitha kane probleme ne hapje –mbyllje dhe ne qendrueshmeri.

Sistemime të jashtme

Territori i ka nje siperfaqe trualli prej 1830 m² nga te cilat 490 m² eshte siperfaqja e e zene me objekte. Ka shesh per reshtim, terrene sportive, siperfaqe te gjelberuar, Ky territor eshte i rrethuar me kangjella te uleta mjaft te vjetra dhe jofunksionale .Muri rrethues dhe rrethimi me kangjella metalike eshte i demtuar .

-Oborri,rruget dhe sheshet janë në gjendjen e tokës natyrale të perbaltur vazhdimisht në kohë reshjesh dhe plot pluhur në kohë të thatë. Ne te njejten gjendje jane dhe terrenet sportive. Persa i perket gjelberimit ai eshte spontan dhe I pa sistemuar

-Pra ambientet me të cilat nxenesit marin kontaktin e parë me shkollën nuk janë aspak edukativë dhe funksionalë.

Mbështetur në analizen e mësipërme rehabilitimi synon të realizojë :

- Mbulesa me cati ekzistuese per vete problemet qe paraqet dhe per kushtet klimaterike te zones, rikonstuktohet duke ndertuar mbi te nje strukture çatie te thjeshte me tjegulla importi, nepermjet te ciles realizohet nje H/izolim pa probleme nemirembajtje dhe nje termoizolim efikas.
- Riparimin dhe suvatimin e mureve komplet
- Tavanet ne katin perdhe duhet te prishen kompet dhe te rishikohet konstruksioni prej druri i dyshemese duke zevendesuar ato te demtuar dhe duke bere edhe perforcime te binareve
- Suvatim e jashtem per uljen e humbjeve te nxehtesise dhe regullimin estetik te objektiti
- Shtresa te reja pllakash per arsye te demtimit te atyre ekzistuese.
- Rikonstruksionin e nyjeve sanitare dhe te reja ne varesi te numrit te nxenesve (vajza,djem)
- Rikonstruksionin e elementeve te levizjes(dyer te jashtme ,shkalle e korridore)
- Rrjetin elektrik

- Sistemimet e jashtme synojnë në:

- disiplinimin e hyrjes së nxënësve në shkollë nëpërmjet hyrjeve të kontrolluara.
- Krijimin e terreneve sportive, fushe volejboli, basketbolli, mini futboll, vegla gjimnastikore.
- Trajtimi me shtresë pllaka betoni dekorative të shesheve
- Krijimi i sipërfaqeve të gjelberuara për kalimin e kohës të pushimit etj

Si rezultat i kesaj nderhyrje arrihet:

- Imazhi me i mire i shkolles
- Ambjente e brendshme te shkolles do rregullohen
- Kushte me te mira mesimi
- Ambjente sportive e palester me kushte pe zhvillim aktiviteti etj.

GRUPI I PROJEKTIMIT

FOTO NGA GJENDJA EKZISTUESE E OBJEKTIT







